

Prishtinë: 02.11.2007  
Kodi i ZRRE-së: D\_62\_2007  
Nr. I Referencës ERO/CPD\_D\_28\_08\_07

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e dhëna Zyrës së Rregullatorit për Energji në Nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Përgjigjen e KEK-ut të datës 08.05.2007 e me numër të referencës HQ-CC1-P21 në ankesën e konsumatorit për lirim nga borxhi i energjisë elektrike;
4. Ankesën e konsumatorit drejtuar në Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorëve ("DMK") në Zyrën e Rregullatorit për Energji ("ZRRE") në pajtim me Nenin 14.1 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë me numër regjistrimi 63/05 2007 të datës 11.05.2007;
5. Vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE lëshuar konsumatorit me datë 01.08.2007
6. Parashtrimi nga ana e konsumatorit të kundërshtimit të vendimit të lëshuar nga DMK e ZRRE-së, drejtuar Bordit të ZRrE-së me datë 06.08.2007:

**Në seancën e mbajtur më 01.11.2007 morri këtë vendim:**

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa E konsumatorit Fane Bytyqi (shifra e konsumatorit - DPR 15922) bërë kundër Vendimit të DMK të datës 08.05.2007, për arsye të paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetimi

1. Me datë 26.04.2007 konsumatori Fane Bytyqi iu ka drejtuar KEK Sh.A – Divizionit Furnizmit – Shërbimit për Konsumator me një kërkesë për tu liruar nga borxhi i energjisë elektrike.
2. Me datë 08.05.2007 KEK-u – Divizioni i Furnizmit – Departamenti për Konsumatorë iu ka përgjigjur konsumatorit Fane Bytyqi duke e refuzuar kërkesën e konsumatorit lidhur me lirim nga pagesa e energjisë elektrike.

3. Me datë 11.05.2007 konsumatori Fane Bytyqi ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë me nr. të referencës HQ – CC – P21 të datës 08.05.2007 në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE me numër të ankesës 63/05 2007.
4. Me datë 01.08.2007 Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) në ZRrE ka refuzuar apelimin e konsumatorit për shkak të këtyre arsytive:
  - 4.1 KEK-u i ka mundësuar dy herë konsumatorës Fane Bytyqi Kontratën për Rregullimin e Borxhit me datë 09.09.2003 në vlerë prej 1,648.00 €, si dhe herën dytë ka nënshkruar Kontratën për Rregullim të Borxhit me datë 07.10.2005 në shumë prej 2,792.87 €. Mirëpo që të dy herët konsumatori Fane Bytyqi nuk iu ka përmbajtur Kontratës ashtu siç është përcaktuar në Kontratën për Rregullimin e Borxhit ku edhe është pajtuar me të gjitha obligimet e kontratës.
  - 4.2 Në ankesën e konsumatorës për zvogëlim të kësteve mujore lidhur me Kontratën për Rregullimin e Borxhit të datës 07.10.2005 në shumë prej 2,792.87 € në 54 këste mujore në vlerë prej 49.70 €, duhet theksuar se Kontrata për Rregullimin e Borxhit është e bazuar sipas Procedurës për Riprogramim të Borxhit dhe se tërë llogaritja e kësteve mujore dhe vlerave të kësteve mujore bëhet sipas kalkulimeve të përcaktuar në Procedurë e jo sipas dëshirave të konsumatorit.
  - 4.3 Konsumatori me datë 13.09.2005, 07.10.2006 dhe me datë 03.03.2007 është njoftuar nga KEK-u me anë të Njoftimit për Shkyçje se duhet ta paguaj borxhin që ka ndaj KEK-ut, sipas Nenit 16.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
  - 4.4 KEK Sh.A me datë 03.10.2005, 10.11.2006 dhe me datë 10.04.2007 pasi që konsumatori nuk i ka përmbushur të gjitha aksionet e specifikuar në njoftimin për shkyçje, pra nuk e ka paguar borxhin e përgjithshëm, punëtorët e KEK-ut e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik me anë të Urdhëresës për Shkyçje, bazuar në nenin 6.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
  - 4.5 Konsumatori është rikyçur dy herë ilegalisht në rrjetin elektrik me datë 26.01.2007 dhe me datë 15.05.2007, me çka punëtorët e KEK-ut pas verifikimit të gjendjes e kanë shkyçur nga rrjeti elektrik me anë të Urdhëresës për Shkyçje, bazuar në nenin 24.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë.
  - 4.6 Sa i përket lirimit nga borxhi i energjisë elektrike, Zyra e Rregullatorit për Energji nuk ka kompetenca ta liroj konsumatorin nga borxhi, vetëm po që se ankesa e konsumatorit ka të bëjë me një kontest konkret dhe KEK-u bënë ndonjë shkëlqje procedurale, atëherë Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE e shqyrton lëndën dhe vjen deri te një vendim.
5. Më 06.08.2007 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK në Bordin e ZRRE-së.

6. Më 01.11.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur një sesion dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur të refuzoj konsumatorin për shkak të arsytiveve të paraqitura në pikën 4 të Vendimit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi konsumatori mund të iniciojë procedurë gjyqi në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

**Kryesuesi i Bordit**

---

**Antarët e Bordit:**

---

---

---

---